



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-226605/22 dt. 18.10.2022, të pronarëve Blerim Devolli dhe Ndërmarrja e Re – Amortizatorët-ndërtesa e Administratës, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës afariste me etazhitet P+G_{galeri}, P+1, B+P+1 e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10315-0, ZK Prishtinë, dhe atë për pjesët e ndërtesës Objekti “1”, “2”, dhe pjesërisht Objekti “3”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 07.02.2023, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LËSHOHET** Certifikata e përdorimit pronarëve Blerim Devolli dhe Ndërmarrja e Re – Amortizatorët-ndërtesa e Administratës, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-226605/22 dt. 18.10.2022, për përdorimin e ndërtesës afariste me etazhitet P+G_{galeri}, P+1, B+P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10315-0, ZK Prishtinë, dhe atë për pjesët e ndërtesës Objekti “1”, “2”, dhe pjesërisht Objekti “3”, sipas Vendimit 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020 për lejimin e ndërtimit të kompleksit të ndërtesave, Vendimit 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.29.09.2021 për Ndryshim-Plotësimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor miratuar me Vendimin e Lejes Ndërtimore, si dhe kërkesës për Ndryshimin e poseduesit të Lejes Ndërtimore, dhe Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.19.10.2021 për Ndryshim-Plotësimin e Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.10.03.2021, mbi pezullimin e zbatimit të Vendimit të lejes ndërtimore, konkretisht Pezullimin e pjesshëm të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020.
- II.** Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimit të Inspektimit Final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Prishtinës Sektori i Ndërtimit.
- III.** Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.
- IV.** Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.
- V.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Blerim Devolli dhe Ndërmarrja e Re – Amortizatorët-ndërtesa e Administratës, me kërkesën 05 Nr. 391/02-226605/22 dt. 18.10.2022, kanë kërkuar nga kjo drejtori, lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës afariste, me etazhitet P+G_{galeri}, P+1, B+P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10315-0, ZK Prishtinë, dhe atë për pjesët e ndërtesës Objekti “1”, “2”, dhe pjesërisht Objekti “3”, sipas Vendimit 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020 për lejimin e ndërtimit të kompleksit të ndërtesave, Vendimit 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.29.09.2021 për Ndryshim-Plotësimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor miratuar me Vendimin e Lejes Ndërtimore, si dhe kërkesës për Ndryshimin e poseduesit të Lejes Ndërtimore, dhe Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.19.10.2021 për Ndryshim-Plotësimin e Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.10.03.2021, mbi pezullimin e zbatimit të Vendimit të lejes ndërtimore, konkretisht Pezullimin e pjesshëm të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020.

Drejtorja e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-166584/22 dt. 13.09.2022 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit,

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Vendimi 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimi 05Nr.351/02-62433/20 dt. 09.09.2020, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Vendimi 05 Nr. 354/01-22715/21 dt. 10.03.2021 për pezullimin e zbatimit të vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020.
- Vendimi 05 Nr. 354/01-22715/21 dt. 05.08.2021 për heqjen e pezullimit të zbatimit të vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020.
- Aktvendimi 05 Nr. 351/01-62433/20 dt.10.09.2021 për ndryshim-plotësim i aktvendimit 05Nr.351/02-62433/20 dt. 09.09.2020, të caktimit të taksës administrative për leje ndërtimi dhe caktimi i taksës shtesë.
- Vendimi 05Nr.351/02-62433/20 dt. 29.09.2021 për ndryshim-plotësim i dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor miratuar me vendimin e lejes ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020, si dhe kërkesës për ndryshimin e poseduesit të lejes ndërtimore.
- Vendimi 05 Nr. 354/01-22715/21 dt. 19.10.2021 për ndryshim-plotësim i vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt. 10.03.2021, mbi pezullimin e zbatimit të vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/01-62433/20 dt. 18.09.2020, konkretisht pezullimin e pjesëshëm të vendimit të lejes ndërtimore 05 Nr. 351/01-62433/20 dt. 18.09.2020.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/01-271929/22 dt. 20.01.2023, Rr. "Lidhja e Pejës" me nr. e hyrjes 107, 109, 111, 115, 117, 119, 121, 123, 125, 127, 129, 133, 135, 137, 139, 141, 145, 147, 149, 151, 153, 157, 159, 161, 163, 165, 167, 169, 171, 173, 175.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Raif Bektashi ida – udhëheqës i punishtes, Lulzim Hadri ida - mbikëqyrës për arkitekturë, Rexhep Saliu idn. - mbikëqyrës për strukturë, Blerim Dyla idh. - mbikëqyrës për hidro-instalime, Endrit Zabelaj bsc. - mbikëqyrës për instalime elektrike, Bekim Krasniqi idm. - mbikëqyrës për instalime makinerike, Arban Shala - mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodezike e licencuar "Ar Consulting" sh.p.k. me nr. të licencës 72.
- Protokollet e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës i prezentuar nga Drejtoria e Inspektionit Sektori i Ndërtimit, me referencë 09 Nr. 391/02-166584/22 dt. 13.09.2022, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-226605/22 dt. 18.10.2022, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës të fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zejtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020, Vendimit 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.29.09.2021 për Ndryshim-Plotësimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor miratuar me Vendimin e Lejes Ndërtimore, si dhe kërkesës për Ndryshimin e poseduesit të Lejes Ndërtimore, dhe Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.19.10.2021 për Ndryshim-Plotësimin e Vendimit 05 Nr. 354/01-22715/21 dt.10.03.2021, mbi pezullimin e zbatimit të Vendimit të lejes ndërtimore, konkretisht Pezullimin e pjesëshëm të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-62433/20 dt.18.09.2020. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa afariste, mund të përdoret.



Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit të Ndërtimit është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesë janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, nëni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa afariste, me etazhitet P+G_{galeri}, P+1, B+P+1 dhe atë për pjesët e ndërtesës Objekti “1”, “2”, dhe pjesërisht Objekti “3”, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-226605/22 DT. 07.02.2023**

Zyrtari:

Arbër Morina

U.D. Udhëheqëse e sektorit

Nazife Krasniqi

Drejtori:

Arbër Sadiki



